

NJË DITË NË KALANË E TETOVËS



Momentet e nisjes

Mëngjesi i 10-të tetorit 2024 nisi me emocion për nxënësit e shkollës sonë. Ishim përgatitur për vizitën e veçantë në Kalanë e Tetovës. Ky udhëtim kishte për qëllim njohjen me historinë dhe trashëgiminë kulturore të rajonit tonë. Me çanta në shpinë dhe aparate fotografike në duar, nxënësit u nisën për të zbuluar plot kuriozitet drejt kësaj qytetit.



Pamje e Kalasë së Tetovës

Qëllimi i aktivitetit

Sapo arritëm në Kalanë e Tetovës, u ndjemë të magjepsur nga pamja e saj madhështore. Kështu, kalasë, të ndërtuara prej gurësh, qëndronin krenare mbi qytet, duke treguar historinë e shekujve. Arsimitarët na tregonin për rëndësinë e këtij monamenti historik, duke na njohur me ngjarjet kryesore që kishin ndodhur aty ndër vite.

Nxënësit morën shënime dhe bënë fotografi për të përgatitur më vonë një fotoreportazh. Pyetjet e tyre reflektonin kureshtje dhe dëshirë për të mësuar më shumë rreth trashëgimisë sonë kulturore.



Argëtimi dhe përshtypjet

Përveç mësimet, ekskursioni ofroi edhe momente të paharrueshme argëtimi. Disa nxënës luajtën futboll dhe volejboll, të tjerë kënduan dhe kërcyen, ndërsa një grup bënë tifozëri duke krijuar një atmosferë

plot gjallëri.



Përfundimi

Pas një dite të mbushur me mësim dhe emocione, u rikthyem në shkollë me kujtime të bukura. Në orën e mësimit, nxënësit përgatitën reportazhet e tyre, duke përshkruar përvojën dhe mbresat nga vizita. Fotoreportazhet më të mira u për zgjodhën për t'u ekspozuar në gazetën e murit të shkollës.

Ky ekskursion ishte një mundësi e shkëlqyer për të mësuar dhe për t'u argëtuar, duke na lënë të gjithëve me një ndjenjë më të thellë lidhjeje me historinë dhe kulturën tonë.

Fotoreportazhin e përgatitën reporterët e rinj të kl. IX-1

Publikoi: Mujdin Sulejmani, arsimtar i gjuhës shqipe